



STRATEGJIA E BORXHIT TË QEVERISË, DHE PËRDORIMI I INSTRUMENTAVE FINANCIARE SI MËNYRA MË EFIKASE PËR MENAXHIMIN E TIJ.

Abstrakt

Shqipëria është në listën e shumë vendeve të cilat përjetojnë situatën e borxhit publik. Kjo nuk është diçka që mund të habitesh sepse është diçka normale për funksionimin e shtetit. Ky borxh lind nga pamundësia e përballimit të shpenzimeve dhe në këtë mënyrë krijohet një diferencë negative në buxhet. Ky hendek negativ duhet të zëvendësohet dhe përballohet, në këtë mënyrë qeverisë i lind nevoja që të ndjek rrugën e borxhit për të mbuluar deficitin ose thënë ndryshe pjesën e shpenzimeve të pambuluar nga të ardhurat. Borxhi është një tregues i keq për shtetin, qeverinë dhe të gjitha entet e tjera drejtuese dhe organizuese, është tregues i keq përball ndërkombëtarëve, institucioneve huadhënëse, bankës botërore dhe FMN-së. Ekzistojnë disa metoda me të cilat mund të financojmë borxhin, mund të përdorim borxhin e brendshëm dhe borxhin e jashtëm. Në borxhin e brendshëm do të përdorësh formë të ndryshme të sigurimit të fondeve ku mund të përmendim, emetimi i instrumenteve të ndryshëm të borxhit, me anë të instrumenteve, mundohet të ruaj një standard të caktuar për të përballuar shlyerjen e tij, sigurimi me anë të rritjes së taksave ose dhe me anë të privatizimeve. Në borxhin e jashtëm do të kemi sigurimin e fondeve nga institucione të specializuara në dhënien e huave të shteteve me deficit buxhetore. Borxhi publik në Shqipëri, është një nga detyrat kryesore për çdo qeveri për ta ulur nivelin e tij, duke përdorur më shumë efektivitetin e fondet dhe të ardhurat e akumuluar. Performanca financiare është treguesi thelbësor për një vend, nëse të gjithë treguesit ekonomik janë në parametrat e duhur atëherë mund të themi që ky shtet po funksionon në mënyrën më të mirë të mundshme. Qëllimi i këtij punimi dhe i përzgjedhjes së kësaj teme është për të evidentuar dhe treguar se përse shkaktohet ky borxh, sa është niveli aktual i këtij borxhi dhe cilat janë efektet "pozitive" dhe negative që sjell borxhi. Ekzistenca e borxhit është diçka negative si për qeverinë ashtu edhe për qytetaret, këtyre të fundit u rëndohet dhe përjetojnë efektin që sjell borxhi. Kujdesi për borxhin publik është hapi kryesor që duhet të bëjë një shtet, ku kujdes duhet të bëhet deri në masën që të mos cenohet përfitimi i shërbimeve të detyrueshme që i takojnë qytetarëve.

Fjalët kyçe: borxh, deficit buxhetor, pasojat ekonomike, llojet e borxhit, instrumentet.

Endrit Liçaj, email: licajendrit@gmail.com

Kujtim Shehu, email: kujtimshehu0@gmail.com